

**THE SONGS OF MOTMOT IN THE COLLECTION “BLETA
SHQIPTARE” OF THIMI MITKO
KËNGËT E MOTMOTIT NË PËRMBLEDHJEN “BLETA SHQIPTARE”
TË THIMI MITKOS**

Adelina XHAFERI¹

¹ *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: adelina.xhaferi@unite.edu.mk*

Abstract

The writing, having in mind that it is short, tries in the plot to reveal, how in the early past of the Albanian society, the folk songs of Motmot, had a special importance, in the way of living, celebration of prayers/gratulations, and also the great creative ability that people had for writing the verses of such songs. The same ones, which are going to be seen in the plot, being inseparable from the human being, also show the functioning of ancient societies, as well as for all the actions which they did consciously, (even when they were related to farming or agricultural work) they dedicated to the Motmot's fest.

Key words: *folk literature, folk songs of MotMot (Albanian celebration), festivals, primitive society, Thimi Mitko, Albanian folklore.*

Përmbledhje

Punimi në fjalë, duke pasur parasysh faktin se është i shkurtër, mëton që brendapërbrenda pak faqeve të tregojë se si, për të kaluarën e hershme të shoqërisë shqiptare, këngët e motmotit, kishin një rëndësi të veçantë, duke paraqitur për të njëjtat, jo vetëm mënyrën e veçantë të jetesës, festimeve a lutjeve/urimeve, por, edhe vetë aftësinë e madhe krijuese që populli kishte për thurjen e vargjeve të këngëve të tilla. Të njëjtat, siç do të shihet brenda në punim, duke qenë të pandashme nga qenia njerëzore, tregojnë edhe për funksionimin e shoqërive të lashta, si dhe për mbarë veprimet të cilat, ato, të vetëdijshme, i bënin kundrejt festave të motmotit, si dhe kundrejt çdo figure a pune (blegtorale a bujqësore) që lidhej me të njëjtën.

Fjalët kyçe: *letërsia gojore, këngët e motmotit, festa, shoqëria primitive, Thimi Mitko, folklori shqiptar.*

Letërsia, bota e veçantë e ndërtuar nga fjalët e bukura e të përzgjedhura të njerëzve me shpirta artistikë, nuk pati gjithmonë formën dhe pamjen të cilën e ka sot, me ç'rast duhet ditur edhe ajo se, e njëjta, jo gjithmonë u përfaqësua me kohë dhe autorë të caktuar. Rrugëtimi i saj i veçantë, shekuj në shekuj, lexuesin (pavarësisht moshës, gjinisë, shkollimit, përgatitjes profesionale ose profesionit të cilin e ushtron) dhe studiuesin, në këtë mënyrë, e kthen shumë vite pas, duke e dërguar jo vetëm te jetesa primitive e shoqërive të ndryshme njerëzore, e cila, qe e zakonshme për kohën e tillë, por, edhe te rrënjët e thella nga zë fill edhe vetë jeta e saj.

E njëjta gjë, pohohet edhe në veprën teorike studimore, në faqet e së cilës, ndër të tjera thuhet se, *“letërsia nuk u bë menjëherë ajo që është sot, ajo u bë shkallë-shkallë, për t’u veçuar e për t’u ndarë nga ai konglomerat kulturor kënge, valleje e rituali fetar, nga i cili doli”*. (Wellek, Warren, 2015:246). Dhe, me këtë rast, për këtë art, që tashmë jeton me njeriun për aq kohë sa ky i fundit ka interes dhe shije për fjalën e bukur, është i nevojshëm të përmendet edhe fakti se, *‘njerëzimi gjithmonë e ka “çmuar” letërsinë, qoftë gojore, qoftë të shkruar, domethënë, ka shfaqur interesim për të, e ka ditur vlerën pozitive të saj’* (Wellek, Warren, 2015:246).

Andaj, në atë që tashmë quhet letërsi gojore ose popullore, nuk mësohet vetëm për atë se si dikur, njeriu, në rrjedhë të vazhdueshme të zhvillimit fizik e mendor, arriti të artikulonte tinguj në mënyrë të drejtë, duke imituar zërat e jashtëm të natyrës, dhe, për të kaluar më vonë te krijimi i vetë fjalëve dhe lidhja e tyre e natyrshme, por, edhe atë se, si i njëjti, e ndjeu nevojën e krijimit të vargjeve të para të këngëve me tematika dhe motive të ndryshme (qofshin ato tematikat shoqërore, fetare, politike, të dashurisë etj, të cilat, vetëm më vonë, kur tashmë bota e kulturuar arriti ta gjykojë krijimin si vlerë dhe brumë për letërsinë e shkruar artistike, morën pamje të tilla).

Me këtë rast ai (njeriu popullor, krijuesi i këtyre vargjeve), si pjesë e një shoqërie të pandashme njerëzore, dëshmoi se, fuqia e tij mendore, ndonëse në rrethana dhe kohëra ende të pazhvilluara, diti të krijojë vargje të bukura, të cilat sot, zënë faqe të tëra në vepra përmbledhëse të folklorit, vlera e së cilave u vu në pah në një shkallë më të madhe, gjatë bartjes dhe trashëgimit të tyre brez pas brezi, për të arritur në këtë mënyrë, me një interes të theksuar, deri në ditët e sotme. Në këtë mes, duhet përmendur edhe fakti se, letërsia, qoftë ajo gojore, ose, ajo e shkruar, ashtu siç edhe është pohuar në vepra studimore, *“gjithmonë duhet të jetë tërheqëse; ajo gjithmonë duhet të ketë një strukturë dhe një qëllim estetik, një lidhje të brendshme dhe një ndikim të përgjithshëm”* (Wellek, Warren, 2015:219).

E tillë është edhe letërsia popullore shqiptare, e cila, ndonëse më vonë bëhet burim i mbarë krijimeve artistike dhe brumë për lindjen e veprave letrare, brenda vetes, siç edhe shihet nga studimet e ndryshme, ka një material (krijimtari gojore) të bollshëm për ta përfaqësuar vetë veten e saj, si dhe për të dëshmuar për ndikimin pozitiv, që e njëjta, kishte (ka) për shoqërinë njerëzore, veçmas atë shqiptare, me tërë vlerat dhe anët estetike, të cilat, si art i mirëfilltë, i ngërthen brenda vetes.

Brenda saj, siç dëshmohet edhe nga vetë trashëgimia gojore, përfshihen këngë lirike (siç janë të njohura lirkat familjare, shoqërore dhe lirkat e dashurisë), këngë epike, pa përjashtuar rastet e ndërthurjeve në mes këtyre dyjave (lirike-epike ose epike-lirike), krijime gojore prozaike, për të kaluar më vonë edhe te krijimet e tilla, siç janë: gjëgjëzat, fjalët e urta, anekdotat etj. Të gjitha këto, me natyrën e veçantë dhe fuqinë e tyre shprehëse, duhet ditur se arrijnë të tregojnë jo vetëm shprehjen e një bote të veçantë popullore shqiptare, me figura (qoftë reale a të fantazuara) të larmishme, por, edhe variantet e ndryshme, të cilat lindën nga koha në kohë, për vetë krijimet e tilla.

Ngase, siç ka thënë edhe studiuesi, meqenëse, njeriu gjatë zhvillimit të tij historik vazhdimisht ka gravituar kah thellimi i përmasave qytetëruese, apo kah përparimi i kushteve tekniko-teknologjike, atëherë edhe përmbajtja e tyre është transformuar duke marrë ngjyrimet e kohës (Murtezani, 2012:16). Brenda saj, duke u nisur edhe nga gjithë ajo larmi krijimesh, më të spikatura, siç shihet edhe në përmbledhje të ndryshme folklorike, dalin këngët, të cilat siç

edhe pohohet nga autori, “me të gjitha veçoritë e tyre që i ngërthejnë në vete paraqesin një segment të rëndësishëm të krijimtarisë sonë popullore. Ato kanë qenë përcjellësi më besnik i jetës së njeriut tonë nëpër të gjitha ecejaket e tij në periudhat e ndryshme kohore” (Murtezani, 2012:15).

Këngët, si elemente shprehëse dhe shoqëruese të përhershme të njeriut shqiptar, tregojnë jo vetëm gëzimin, të cilin, po ai njeri e ndjente me lindjen e fëmijës (me një theks të veçantë për lindjen e fëmijës mashkull), por, edhe çdo gëzim që, për të, vinte nga çastet e syneve, fejesës a martesës së njerëzve të familjes a të fisit. Të njëjtat, ndonëse jo gjithmonë me natyrë dhe shprehje pozitive, arritën që po këtë njeri ta shoqëronin edhe në çastet e tij të hidhura, siç janë: çastet e ceremonive mortore, marrjes së djemve me dhunë nga popujt tjerë (rastet e nizamëve), çastet kur ai vajtonte plagët e kurbetit, apo, edhe më keq, ndarjen e përhershme nga njerëzit e dashur, qoftë me vendim të vetin, apo, me humbjen e jetës në tokë të huaj. Pra, thënë me një fjalë, këngët e tilla e shoqëruan njeriun në një rrethanë të caktuar, që nga djepi deri në varr.

Kjo letërsi, e cila, në fillimet e veta lindi atje tek njerëzit jetonin të mbledhur në fise e në shoqëri të caktuara dhe me një botëkuptim ndryshe për botën, siç u përmend edhe më lart, brenda këtij punimi, u bë burim i të gjitha periudhave të mëvonshme letrare, jo vetëm në rastet e bartjeve së ca elementeve të vogla brenda krijimeve të caktuara letrare, por, edhe për vetë krijimin në tërësi. Një bartje/huazim të tillë, nga letërsia gojore, në atë artistike, bënë përfaqësues të ndryshëm të letërsisë sonë, jo vetëm në kohën, kur tek ajo duhej ta kishin mbështetjen kryesore, meqë e njëjta ishte mjaft e pasur, si për nga aspekti gjuhësor, ashtu edhe nga ai stilistik, por, edhe atëherë kur po kjo shprehje arriti kulmin e saj letrar, dhe, për të njëjtën edhe u veçua nga ajo.

Nga gjithë kjo, duhet thënë se, letërsia, bota e madhe e fjalëve të bukura e figurative, lindi bashkë me njeriun, dhe se, vetëm falë zhvillimit të tij mendor, arriti që të zhvillohet edhe ajo, me ç’rast i njëjti, edhe në kohët e mëvonshme ishte i vetëdijshëm që një art të tillë të veçantë e me përmasa të gjëra, ta fuste në korniza të denja letrare. Në këtë mes, për të njëjtën, nuk duhet lënë anash as rastet, kur figura dhe personalitete të caktuara të botës letrare dhe kulturore shqiptare, mëtuan të mblidhnin krijime të shumta gojore, dhe të njëjtat, t’i fusnin në vepra të caktuara. Për këtë punë, ata u ndihmuan nga të gjithë njerëzit e tjerë, të cilët, falë bartjes së krijimtarisë gojore nga brezi në brez, arritën të dëshmonin një pasuri tonën të madhe folklorike.

Në mesin e shumë emrave, të cilët u morën me mbledhjen e krijimeve gojore shqiptare, nuk mund të lihet anash dhe, pa u përmendur as Thimi Mitko (1820-1890), puna kryesore e të cilit, tashmë është e njohur se, merret si përfaqësuese e periudhës së Romantizmit shqiptar, por, edhe për pjesën që i takon letërsisë popullore, nuk lihet anash, ngase vetë vepra e tij, një përmbledhje e larmishme folklorike “*Bleta shqiptare*” llogaritet si vepër përfaqësuese për të ashtuquajturën letërsi popullore shqiptare.

Mitkoja, siç tashmë edhe është e njohur, brendapërbrenda asaj që ngërthejnë kornizat e letërsisë, e hapi rrugën e gjatë për mbledhjen e folklorit shqiptar, duke dëshmuar se këtë punë nuk e bëri vetëm brenda hapësirave të trojeve shqiptare, por, edhe në vendet, në të cilat shqiptarët do të zinin vende për një jetesë më të mirë për sa i takon aspektin ekonomik, ose për të qëndruar larg sundimit të huaj, dhe se kjo rrugë e tij, e nisur në kohë trazirash, por, me frute të ëmbla në kohën e mëvonshme, do të ndiqet edhe nga mbledhës të tjerë folklorikë, siç janë të njohur emrat: Anton Çetta, Qemal Haxhihasani, Rahmi Tuda etj.

Kjo përmbledhje e Thimi Mitkos, të cilën ai filloi ta mblidhte me zell që nga viti 1860 deri më 1878 (Grup autorësh, 1990:14), e botuar në Aleksandri, në vitin 1878 është përmbledhja e parë e letërsisë sonë popullore shqipe, e cila do të sjellë lëndën më të çmueshme, në të cilën do të mbështeten mendimet mbi vlerën e lartë artistike dhe mbi rëndësinë historike dhe kulturore të thesarit shpirtëror të popullit shqiptar (Qosja, 2000:284/285). Ajo llogaritet si përmbledhja më e mirë, si në pikëpamje të kohës dhe të hapësirës në të cilën është krijuar, ashtu edhe në pikëpamje të vlerës me të cilën është krijuar kjo letërsi (Qosja, 2000:285).

Këtë gjë e dëshmon fare mirë, edhe vetë parathënia të cilën ai e vendos në vepër, në të cilën, ndër të tjera thuhet se: *‘Qëllimi i “Bletës shqiptare” është shpëtimi dhe dhënia e brezave që vijnë, i fjalëve dhe i teksteve shqipe...të cilat besojmë se do të kenë vlerë...sepse në to duken fisi, karakteri, fati e zakonet e racës shqiptare...’* (Grup autorësh, 1990:15). Me këtë rast, dëshmohet se Mitkoja, njeriu me një përgatitje të madhe, si intelektuale, ashtu edhe letrare, ndryshe nga mbledhësit e tjerë të folklorit (pavarësisht kohës dhe rrethanave të tjera parandaluese), iu kushtua mbledhjes dhe publikimit të thesarit shpirtëror të popullit, në radhë të parë, për: *“ta shpëtuar atë prej harresës; për të kënaqur kërkesat kulturore kombëtare; për të ndihmuar studimin e traditave kulturore dhe, në përgjithësi, të historisë kombëtare”* (Qosja, 2000:298).

Këtë vepër, e cila shquhet jo vetëm për anën voluminoze dhe të bollshme për materiale të mbledhura gojore në zona të ndryshme gjeografike, ndër të tjera, e karakterizon edhe shija e veçantë e Mitkos për përzgjedhjen e materialit. Në këtë rast, dhe në interes të vetë punimit, duhet ditur edhe ajo, se, Mitkoja këtë vepër e botoi duke përdorur me ndryshime fare të vogla, alfabetin grek të Kamaradës, duke u përpjekur kështu për një besnikëri dhe organizim të mirëfilltë të sistemimit në rubrika të caktuara të materialit të mbledhur (Zheji:17).

Ajo që del interesante për këtë pjesë, është edhe fakti se, Mitkoja, një personalitet i shquar për botën e letrave shqipe, siç thuhet edhe vetë brenda një studimi të caktuar, *“është kujdesur të mbledhë krijime popullore të gjinive, të llojeve dhe të formave të ndryshme. Kështu, fjala vjen, mund të vërehet se ka mbledhur: këngë të vegjëlsh; këngë komike; këngë që këndohen në muajin maj; këngë që këndohen kur bie shi, këngë që këndohen kur dalin dhëmbët për të dytën herë; këngë që këndojnë çupat ditën e parë të marsit; këngë që i kushtohen hënës së re; këngë për lulet e zogjtë; këngë të motmotit; këngë për festat; këngë që këndohen kundër gjarpërinjve dhe kafshëve të tjera të dëmshme; këngë dashurie me nënlojet e këngëve të dasmës, të këngëve të nizamit e të këngëve të kurbetit; vaje dhe këngë të përjavshme; këngë epike, balada; këngë historike; mandej përralla; fabula; anekdota; fjalë të mençme; gjëgjëza ose, si i quan vetë Thimi Mitko, fjalë të errëta; të përshëndoshura; emra karakteristikë myslimanësh dhe të krishterësh, mbiemra karakteristikë familjesh, e të tjera”*. [siç!] (Qosja, 2000:288).

Në pjesën e mëposhtme, interesi i këtij punimi do të jetë vetëm te këngët e motmotit, të cilat njeriu primitiv e kanë shoqëruar në festat e ndryshme të kohës, nisur nga ajo që tashmë dihet se festa, *“qëndron në vetë psikikën e njeriut”* (Murtezani, 2012:84), e që si e tillë, gjithmonë, pavarësisht kohës, *“paraqet nevojë shpirtërore për t’u sfiduar njëtrajtshmëria, apo banaliteti e monotonia e përditshme”* (Murtezani,2012:84). Dhe, duke pasur parasysh faktin se jeta e njeriut është e ndërthurur me çaste të shumta (siç njihen ata të lindjes, zhvillimit të jetës a të përfundimit të saj, d.m.th çaste, të cilat njeriu e ngërthejnë që nga lindja deri në varr), brenda së cilave ai mëton ta shprehë edhe ndjenjën më të vogël, atëherë, të pamposhtura sigurisht se janë ndjenjat e festave në të cilat ai e nxjerr tërë botën e vet.

Kjo e fundit, nuk ngelet anash as edhe atëherë kur njeriu i një shoqërie të atëhershme primitive, i nxitur nga vetë rrethanat në të cilat jetonte, thuri vargje edhe për ndodhitë e ndryshme të natyrës (për festat, të cilat ai, ia veshte asaj, nisur nga kalendari shoqëror primitiv), e cila në të njëjtën kohë, jo vetëm që, për të paraqiste vendin e vetëm të jetesës, në bashkësi të detyruar me të tjerët, por, edhe frymëzimin a nënshtrimin e tij. Në këtë mënyrë, siç edhe del nga vetë krijimet e ndryshme me karakter popullor, shihet se kujdesi për natyrën dhe për punët, të cilat e njëjta ia mundësonte njeriut të asaj kohe, ishte mjaft i lashtë, meqë me të, e lidhte vetë ekzistencën dhe vazhdimësinë e jetës së vet.

Këngët e tilla, të cilat në këndvështrimin e sotëm tregojnë për një traditë të begatshme të shoqërisë së atëhershme shqiptare, si dhe për një vlerë të pamohueshme, pavarësisht kapërcimit të kohës dhe kërkesave të cilat e njëjta i shtron përpara të tjerëve, të bartura brez pas brezi, paraqesin manifestimet/organizimet e ndryshme të cilat ndodhin për hir të natyrës, teksa këtë të fundit, herë e lusnin për të mira të njëpasnjëshme, e herë të tjera, edhe i faleshin.

Njeriu i lashtë shqiptar (dhe jo vetëm), nëpërmjet këtyre festave, siç e thekson edhe vetë studiuesi, “*ka përcaktuar ndryshimet që ndodhnin në rrafshin kohor e të cilat shënojnë ndonjë kthesë, qoftë në kuadër të proceseve kalendarike, qoftë të atyre antropologjike*” (Murtezani, 2012:73). Festat në fjalë, të organizuara nga njerëzit, që, ndonëse primitivë, për botën e sotme tashmë pranohen si genie me aftësi mjaft të madhe krijuese, duke u nisur edhe nga vetë trashëgimia gojore e shfaqur në ditët e sotme, “*paraqesin bartje të përvojës spontane autentike kulturore si rrjedhojë e botëkuptimit të kufizuar ndaj realitetit objektiv, qoftë të njeriut të lashtë, por edhe atij më të vonshëm. Ato, si modele të veçanta kulturore në përmbajtjen e të cilave reflektohet mendësia kolektive, kanë kaluar nëpër një rrugë të gjatë të ekzistencës së tyre, madje duke mbijetuar edhe sot e kësaj dite*” (Murtezani, 2012:73).

Por, të tillat, edhe pse me natyrë të transformuar në rrjedhë të pandalshme të shekujve, sërish, me një theks më të veçantë në ditët e sotme, tregojnë për festime pagane. Të tillat, edhe pse me kalimin e kohës iu veshën më tepër njerëzve të krishterë, nisur nga ajo që, kisha, si institucioni më i lartë dhe më i fuqishëm fetar, pati ndikimin më të madh që ato, si festa të ashtuquajtura pagane të mbarë popullit, t’i kthente në anën e vet, dhe, çdo cikël jetësor, ritual a hollësi ta mënjanonte nga pagania (Murtezani, 2012:76), sërish, bëjnë që disa elemente të tyre të hasen/vërehen edhe te njerëzit e besimeve tjera, duke treguar kështu, se festat “*kanë qenë të ndërlidhura me nevojat biologjike, apo ekzistenciale, andaj, si rrjedhojë edhe me dy degët kryesore të veprimtarisë ekonomike, si bujqësia dhe blegtoria. Në funksion të kësaj logjike, ato është dashur t’i përshatën kalendarit agrar dhe segmenteve të vitit të cilat përkojnë me ndryshimet klimatike natyrore*” (Murtezani, 2012:75).

Praninë e këngëve të motmotit në vetë folklorin e popullit shqiptar, siç u theksua edhe në fillim të këtij punimi, në një shkallë mjaft të ngritur në raport me të tjerat, e dëshmon përmbledhja popullore e Thimi Mitkos, duke treguar në këtë mënyrë se, të parët tanë, ndonëse detyrimisht pjesë e shoqërive primitive, kanë besuar në forca të mbinatyrshme, dhe se për të njëjtat, jo vetëm që kanë vepruar bashkë si shoqëri, për sa i përket besimit, por, edhe për nga veprimet e shumta kundrejt së njëjtave (siç janë: ndezja e zjarrit, formimi i kurorave me lule, vënia e degëve në derë, përgatitja e kulaçeve etj).

Këtë gjë, brendapërbrenda këtyre vargjeve, të cilat i ngërthen vepra e Thim Mitkos, e tregon konkretisht edhe vetë përmendja e shpeshtë e elementeve të pashterura natyrore, si “zjarr” dhe “uji”, funksioni i të cilave, si në përditshmëri, ashtu edhe në brendi të veprës, del se është pastrimi i rrënjësishëm i objekteve. Por, në këtë rast, për këto elemente, duhet pasur parasysh faktin se, i pari (zjarri) spastron duke e djegur të keqen, kurse i dyti (uji) e spastron duke e lënë në këmbë fenomenin a vetë objektin e spastruar (Zheji:43).

Nga gjithë kjo që u tha deri më tani, e siç do ta dëshmojnë edhe vetë përzgjedhjet e këngëve të mëposhtme, duhet thënë se, “*forastësisht, në përmbajtjen e festave kalendarike pagane nëpërmjet të cilave shënohet kalimi në një periudhë tjetër kohore, dominojnë objekte të cilat shënojnë, apo simbolizojnë “vdekjen” dhe “ringjalljen” e sërishme. Të kësaj natyre janë vezët, zjarri, vegjetacioni e kështu me radhë*”. [sic!] (Murtezani, 2012:76). Kjo gjë del si më poshtë:

“Lazare, o Lazare,
ngreu, ngreu, se u err.
Erdhëm të kërkojm’ një ve,
të na bojë nusja nder.
Ti, moj lule kumbulaise,
nderomë, moj bukuraise,
nganjëherë mot për mot,
zonj e shtëpis’ për shumë mot!
Nemë, ti, një koqe ve,
ashtu qofsh, gjithmon’ e re,

*zoti t'boft më mir' se je,
n'daç në qiell, në daç në dhe.
Në më dhanç një koqe fik,
ashtu u gdhifsh sa një calik;
në më dhanç një dor' barot,
çuni jyt u boft dhespot;
në më dhanç një koqe ballë,
çuni jyt u boft dhaskal.
Sa lesh mbi ata deshë,
kaqe të mira të kesh.
Sa furka mb'ato kasolle,
kaqe nuse punëtore.
Sa gjethe ka ay ulli,
aqe qypa me flori.
Për shum mot, për shum vjet
burri jyt u boft një mbret". [sic!] (Mitko, 1981:90/91).*

Në këngën popullore në fjalë, shihet se, që në vargjet e para, lexuesi i sotëm njihet me një thirrje mbarë popullore, e cila, në këtë rast del kundrejt një figure të rëndësishme, dhe se, përmendja e tij e shpeshtë, tregon dhe për vetë peshën, që ai, me fuqinë dhe veprimet e tij, kishte për shoqërinë e atëhershme. Kur flitet për veprimet, siç del edhe nga vetë natyra e këngës në fjalë, shihet se ato, kishin të bënin përherë me anën kolektive dhe me të mirat a të këqijat, të cilat i uronin në rast se do të përmbusheshin dëshirat e thëna. Andaj, jo më larg se në këto këngë, lexuesi, njihet dhe me anën e veçantë të urimit të shoqërisë së atëhershme shqiptare, urim ky i cili, lidhej, jo vetëm me çastin e organizimit dhe manifestimit të festës sipas mënyrave të kohës, ose me figurën të e cila thuhej thirrja, por, edhe me mbarë rrjedhën e vitit dhe, anëtarët tjerë.

Interesant është dhe fakti, që, kënga në fjalë, brenda vetes, ndonëse lidhet vetëm me një festë të caktuar pagane, e më vonë lidhet vetëm me anën krishtere (siç del edhe nga emri i përmendur, Lazar), ka dhe metaforën e gjetur letrare, duke treguar në këtë rast se, nëse një nuse a grua/zonjë shtëpie e bukur, do të jepte te kërkuesi gjënë e dëshiruar, fëmijët do t'i uroheshin për t'iu bërë zotërinj e mësues të denjë, gjë që dëshmon, se, vetë krijimi i vargjeve të këtilla, lidhet dhe me të nesërmen e brezave të mëvonshëm; ose, në raste të tjera, i zoti i shtëpisë të mund t'ia merrte rolin e një mbreti e të udhëhiqte me të tjerët. Pastaj, sigurisht, se nuk duhet harruar së përmenduri edhe fakti, se, në këngë, ashtu siç edhe dëshmohet vetë, mbizotërojnë elementet e hershme të zonave rurale, siç është rasti me përmendjen e fjalëve: desh, kasolle, qyp etj.

Ana e veçantë e këngëve të motmotit, të cilat për kulturën e hershme shqiptare tregojnë mënyrë të caktuar jetese dhe festimi, sigurisht se nuk mbetet anash as edhe te kënga e mëposhtme, e cila, siç edhe shihet, sërish, të bartur si subjekt lirik e ka figurën fetare (krishtere) të ashtuquajtur Lazar, te i cili, tashmë u mësua se bie barra më e madhe e këtyre këngëve:

*"Erdhi Lazari mbë derë,
bjeri pulësë të pjellë,
jepni Lazërit një ve,
se u err e do të ve.
Do të vejë ndë More,
janë turqit e krishte,
kanë gjalp e mono ve.
Ng' atje para vjen andara,
shën Mëria tye klara,*

*tye klar' e tyre thirrë,
se i vranë monobirrë.
Mbëlithni lule, lule malit,
të ia vëmë torrë varit". [sic!] (Mitko, 1981:91).*

Nga leximi i saj, shihet se, në pjesën e saj të fshehur fshihet vetë zëri i popullit, i cili, duke synuar një të ardhme të ndritur, thërriste që të veprohej në mënyrë pozitive (duke i dhënë të njëjtit një vezë), meqë nga vetë veprimet e tyre do të ndikohej edhe veprimi i Lazarit. Ky i fundit, në këtë këngë jepet bir i Shën Mërisë, figurës madhore krishtere, e cila, duke ditur faktin se e kishte djalë të vetëm, për çdo të keqe që do t'i bëhej të njëjtit, do të guxonte ta dënonte mbarë popullin. Domethënë, edhe për mendësinë e atëhershme shoqërore, njeriu prirej të vepronte në mënyrë pozitive kundrejt palëve tjera, për të dëshmuar në këtë mënyrë jo vetëm respektin që mund të kishin, duke vënë mbi varr tufa të tëra lulësh, por, edhe mënyrën se si do të funksiononte në përgjithësi e nesërmja e tyre. Këtë gjë, kjo këngë e dëshmon në secilin varg.

Një lirikë të veçantë motmoti paraqet edhe kënga e mëposhtme, e cila, duke pasur parasysh faktin se femra, ishte shoqëruesja e përhershme e të gjitha qenieve të tjera mbi tokë, shoqëria edhe me mendësinë e atëhershme, vendosi që në shumicën e këngëve të krijuara nga to, ta bënte subjekt të vetëm e të veçantë lirik. E njëjta, ndonëse në shumicën e rasteve të këtyre këngëve nuk jepet me përskrime të thella, lexuesi rreket që të njëjtën gjithmonë ta shohë si një figurë të bukur e të rrethuar në çdo kohë me fuqi të madhe mendore. Në këngën me vargjet e mëposhtme, e njëjta, shihet se, si pjesë e një grupi të caktuar të njerëzve (vashave tjera), kërkon që të bëhet pjesë e çdo veprimi të bukur që mund ta bënin të tjerët. Në këtë rast, ajo edhe po të mos dinte të mblidhte manushaqe, e bindur se do të ndihej mirë dhe e gatshme për çdo gjë të bukur, siç del edhe në këngë, me mall e pret, vënien e tyre mbi faqe, ose mbi kokë, si kurorë. Ja si del kjo:

*"Ndë vafshi për manushaqe,
mëmëni edhe mua.
Pa ndë mos diça t'i mbledh,
psomëni edhe mua.
Ndë mos diça t'i bënj tufë,
psomëni edhe mua.
Tufë, tufë manushaqe,
T'i rënditimë mbi faqe." [sic!] (Mitko, 1981:94).*

Subjekti lirik femër, që këngët e motmotit pothuajse e vënë veprimin gjithmonë mbi kokën e saj, del edhe në këngën e radhës, e cila, që në vargjet e para shfaq anën e bukur të urimeve të shoqërisë së kohës, me rastin e festave të ndryshme të motmotit të përfshira në kalendarin e kohës, për të dalluar kështu kohën e ftohtë (dimrin) nga koha e ngrohtë (verën), të ndara në mes me nga gjashtë muaj. Ja si del kënga në fjalë:

*"O kolendra melendra!
Mirëdita, moj kadënë
mire sod, mire mote,
ashtu dalç për shumë mote.
Dil kadënz'e shtëpisë,
hap derën e perëndisë,
nxir kullakn'e zotërisë.
Dil, moj, dalç e bardhë,
gjer' mot me një djalë.
Dil mo, dalç e kuqe,
gjer' mot me një nuse". [sic!] (Mitko, 1981:95).*

Siç edhe shihet, në rastin e kësaj kënge, kemi përmendjen e shpeshtë të thirrjes për daljen jashtë, veprim të cilin, zonja e shtëpisë, duke u përkujdesur për të mirën e përgjithshme, duhej ta bënte edhe në raport me të tjerët, për festa të caktuara motmoti, dhe, me këtë rast do ta nderonte jo vetëm familjen nga e cila rridhte bardhësia dhe fati i saj, por, edhe vetë perëndinë (elementin fetar) dhe fuqinë e tij të paarrtshme nga qeniet njerëzore. Hapja e derës së shtëpisë së saj, ndonëse në këto këngë tregon për mënyrë të lashtë jetese dhe respekt të veçantë ndaj figurave madhore, po të lidhet me kohën e mëvonshme, dhe me çdo gjë, që arriti të dokumentohet në vepra të caktuara, pavarësisht natyrave të tyre, shihet se e njëjta ka pika përafruese edhe me natyrën e “*Kanunit të Lekë Dukagjinit*”.

Gjithë kjo thuhet, nisur nga fakti se, edhe Kanuni, dokumenti i vetëm i funksionimit të shoqërive shqiptare në zonat malore, kërkonte që, pavarësisht kohës dhe rrethanave tjera, të cilat mund të ndikonin te veprimet e njerëzve, dera e shtëpisë duhej të hapej për këdo që trokiste, qoftë ai edhe vetë armiku. E fundit për këtë punim të shkurtër, do të jetë edhe kënga me vargjet e mëposhtme, e cila, me tërë natyrën e vet, duke pasur parasysh faktin, se njëjtë, lidhet me një festë të caktuar motmoti, e pohon atë që u tha më lart në punim, se këto festa, nuk lidheshin vetëm me anën shpirtërore të njerëzve, por, edhe me çdo përgatitje, që të njëjtët bënin në kohën e tyre. Këtë gjë, brenda kësaj kënge e dëshmon dhe përmendja e kulaçit. Ja se si del përmendja e tij më poshtë:

*“Mirëdita për këllana,
me një par’kupa t’argjana.
Mirë sod e mirë mot,
na ndihmo, i lumi zot!
Del, zoja, zoj’e shtëpisë,
me kulaç të zotënisë.
Del e del e dalç e bardh,
sod me barr’e mot me djalë.
Këtu ka një shej’ të mirë, shej’ të mirë
kalë kamëbardhë, vithe të prarueme,
zojë të garkuese.
Apo del, apo shkojmë?” [sic!] (Mitko, 1981:95).*

Përgatitja e kulaçit për festat në fjalë, dhe çdo ritual që bëhej për thyerjen dhe ngrënien e tij, tregon në të njëjtën kohë, që, secili person i shoqërisë në fjalë, është munduar për një të ardhme më të mirë, dhe për një vit të begatë. Ky i fundit, sipas urimeve të njerëzve që këndonin këto këngë, do të ishte më shumë për zonjën e shtëpisë, e cila, me duart e saj të bardha, nga gatimi i kulaçit, do ta gatonte në një mënyrë figurative dhe vetë jetën e një qenieje të mëvonshme në atë shoqëri, domethënë do ta lindte një djalë. E që ajo shoqëri të kishte fat, duhej ta vlerësonte jo vetëm festën e çdo gjë që lidhej me jetën e tyre të thjeshtë, por, dhe vetë uruesin e ditëve të tilla. Duhet thënë edhe ajo se, shoqëria shqiptare, vlerën e këtyre këngëve të lashta popullore, e ruan edhe sot e kësaj dite, ndonëse për disa nga to, tashmë nuk organizohen festa e kremtime të veçanta, por që, gjithmonë do të tregojnë për diçka tonën të kaluar e të mbushur me mjaft shpirt.

Referencat

- [1]. Grup autorësh, (1990), Folklori shqiptar, Mihal Duri, Tiranë;
- [2]. Mitko, Th., (1981), Vepra, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë;
- [3]. Murtezani. I., (2012), Varietete folklorike, Vatra, Shkup;
- [4]. Qosja, R., (2000), Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi II, Botimet Toena, Tiranë;
- [5]. Zheji. Gj., Hyrje në folklor I, Phoenix, Tiranë;
- [6]. Wellek,R., Warren, A., (2015), Teoria e letërsisë, Onufri, Tiranë.